



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1088_01_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 27.02.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 prill 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Xh. K. me shifër të konsumatorit: DPR – 90040256) nga Fushë Kosovë ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1188_01_14 i datës 28.01.2014.

Arsyetim

Me datë 04.01.2013 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2012 në vlerë financiare **235.11 €**, si dhe me datë 03.02.2013 për periudhën janar 2013 në vlerë **225.13€**. Pas kësaj konsumatori me datë 02.05.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën e muajit dhjetor 2012 dhe janar 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë.

Me datë 20.06.2013 punëtorët e autorizuar të KKDFE-së për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 12355158: TL=017023 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 034879h kW (tarifa e ulët).

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 09.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar faturën për muajin në dhjetor 2012 në vlerë financiare **235.11 €**, si dhe faturën për muajin janar 2013 në vlerë financiare prej **225.13€**. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 28.01.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS që: 1) Korrigjoj faturat e konsumatorit për periudhën nëntor 2012 deri në dhjetor 2013 duke bërë shpërndarjen e shpenzimit (kWh) të regjistruar në relacion 70% në tarifën e lartë dhe 30% në tarifën e ulët, bazuar në strukturën e tanishme tarifore të aprovuar nga ZRRE (tarifa e lartë për sezonën e lartë 07:00 h – 22:00h, ndërsa në sezonën e ulët 08:00h- 23:00h); 2) Bëjë rregullimin e ndërruesit tarifor bazuar në strukturën e tanishme tarifore të aprovuar nga ZRRE (tarifa e lartë për



sezonën e lartë 07:00 h – 22:00 h, ndërsa në sezonën e ulët 08:00h - 23:00h) në mënyrë që konsumatori të faturohet për shpenzimet reale të shkaktuara në dy tarifafat.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në bazë të listave të leximit kartë shihet se konsumatori ka pas lexim të rregullt dhe se energjisë elektrike ju ka faturuar vetëm me një tarifë dhe atë sipas tarifave për shitje me pakicë grupi tarifor nën pikën 6 – 0.4 kV matësi tarifor shtëpiak. Pika 2 e kundërshtimit është për faktin se KEDS-i nuk është obliguar që konsumatorit të ja mirëmbaj tariforin e njehsorit mekanik ngase njehsorët e tillë tariforin e kanë të veçantë andaj është i pakuptim një vendim i tillë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 prill 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit se konsumatori ka pasur lexim të rregullt sipas vendimit të tarifave me pakicë për konsumatorët shtëpiak. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se një vlerësim i tillë nuk qëndron pasi që faturimi i bërë këtij konsumatori është në kundërshtim me strukturën tarifore të aprovuar nga ZRRE, pasi që njehsori elektrik përveç tarifës së ulët duhet të bëjë regjistrimin e energjisë së shpenzuar edhe në tarifën e lartë, andaj DMK ka udhëzuar KKDFE që konsumatorit t'i bëhet korrigjimi i faturave nga periudha 10/2012 deri në 12/2013 duke bërë shpërndarjen e kWh të regjistruar në relacion 70% në tarifën e lartë dhe 30% në tarifën e ulët bazuar në strukturën e tanishme tarifore të aprovuar nga ZRRE (tarifa e lartë për sezonën e lartë 07:00h – 22:00 h, ndërsa në sezonën e ulët 08:00 h- 23:00h). Po ashtu DMK ka udhëzuar KKDFE-në që të bëjë rregullimin e tariforit bazuar në strukturën e tanishme tarifore të aprovuar nga ZRRE (tarifa e lartë për sezonën e lartë 07:00 h – 22:00 h, ndërsa në sezonën e ulët 08:00- 23:00).

Sa i përket pikës 2 të kundërshtimit, se KEDS-i nuk është obliguar që konsumatorit ti rregulloi tariforin e njehsorit mekanik dhe se kjo nuk është përgjegjësi e KEDS të kryej veprime tilla. Bordi i ZRRE-së, pas analizimit dhe vlerësimit edhe të kësaj pike ka konstatuar se bazuar në neni 32 paragrafi 1 të Ligjit të Energjisë Elektrike theksohet: **“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”**, andaj sipas kësaj dispozite ligjore KEDS është i obliguar të kujdeset për gjithë pikën matëse të konsumatorit duke përfshirë edhe tariforin e këtij konsumatori.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1188_01_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar